

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2017

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, në vijim ISKK, si institucion studimor publik i pavarur, me rëndësi të veçantë për trajtimin e periudhës së regjimit komunist në Shqipëri dhe çështje që kanë të bëjnë me kujtesën kolektive.

Rolin e ISKK-së në dokumentimin e veprim-tarisë së organeve dhe të strukturave të ish- regjimit komunist në Shqipëri, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist.

Botimin nga ISKK-ja të vëllimit të gjashtë të kolanës “Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist”, i cili pasqyron statistikisht në mënyrë të dokumentuar proceset inkuizitore politike ndaj qytetarëve gjatë periudhës së regjimit komunist.

Zbatimin në vazhdimësi, gjatë vitit 2017, të marrëveshjes midis ISKK-së dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për informimin e nxënësve të shkollave të mesme të kryeqytetit, në lidhje me krimet dhe format e përndjekjes së qytetarëve gjatë diktaturës komuniste, luftës së klasave, biografisë, dëbim-internimeve etj.

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2017 ISKK-ja:

Në zbatim të marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, edhe gjatë vitit 2017 ka realizuar me sukses fazën pilot të projektit të bisedave në shkollat e mesme të Tiranës, për informimin e të rinjve mbi epokën komuniste.

Ka botuar 22 libra (studime shkencore, botime dokumentuese, memuare, letërsi publicistike, literaturë nga burgjet, botime historike).

Ka botuar vëllimin e gjashtë të kolanës “Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist”, i cili pasqyron statistikisht në mënyrë të dokumentuar të gjithë viktimat e regjimit komunist, format e dënimit, masën e dënimit, vendimet ligjore dhe jetëshkrimin.

Janë realizuar rreth 40 orë videoregjistrime të dëshmimeve të të mbijetuarve nga burgjet dhe kampet e regjimit komunist nga stafi i institutit.

Ka kryer konsultimin dhe realizimin e fazës përgatitore të projektit “Muzeu virtual i komunizmit”, i cili pritet të konkretizohet gjatë vitit 2018.

Ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me “Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” (AIDSSH) për shfrytë-zimin e arkivave dypalëshe, duke përmbyshur rekomandimin e bërë në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë të vitit 2017 për vlerësimin e veprimtarisë së ISKK-së.

Plotësimi i *database*-it dhe arkivave audiovizuale e dëshmimeve të të mbijetuarve vazhdojnë të mbeten një aktivitet konstant i ISKK-së, ndërkohë që në faqen zyrtare të ISKK-së, akoma nuk është bërë i mundshëm aksesimi *online* i të gjitha botimeve, literaturës dhe dokumentacionit.

Ka konsoliduar bashkëpunimin me universitetet, kryesisht përmes temave studimore në nivelet master/doktoraturë, por dhe përmes *intership*-it.

Ka publikuar studime të plota dhe të pjesshme, gjatë vitit 2017, në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, revista shkencore, në median e shkruar dhe median elektronike.

Ka realizuar disa aktivitete mediatike lidhur me njërin nga aspektet e periudhës komuniste, siç është ai i propagandës përmes filmit.

Kuvendi i Shqipërisë, përgjatë vitit 2018, kërkon nga ISKK-ja:

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të

vazhdojë informimin e të rinjve të shkollave të mesme mbi periudhën e regjimit komunist në të gjithë territorin e vendit.

Të evidentojë dhe të studiojë mekanizmat e kontrollit absolut të ish-regjimit komunist në të tria pushtetet: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si mënyrë për të kuptuar natyrën e totalitarizmit dhe impaktin në strukturën social-kulturore të shoqërisë gjatë periudhës së regjimit komunist.

Botimet e përgatitura nga ISKK-ja t'u nënshtrohen analizave paraprake dhe miratimit nga bordi shkencor i ISKK-së, përpara botimit të tyre.

Të kryejë studime të tipologjisë së metodave të veprimit të ish-Sigurimit të Shtetit,urvejimi, nënshtrimi psikologjik dhe moral i qytetarëve, në bashkëpunim me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

Të konsolidojë bashkëpunimin me AIDSSH-në, me fokus të veçantë çështjet që kanë të bëjnë me aksesimin e arkivave nga të dyja institucionet.

Të vazhdojë informimin, me qëllim rritjen e ndjeshmërisë publike ndaj krimeve të komunizmit, përmes aktiviteteve akademike, botimeve, medias dhe rrjeteve sociale.

Të përmirësojë transparencën dhe efikasitetin e institucionit, përmes zgjerimit të bashkëveprimit me institucionet të tjera, universitetet dhe qendrat studimore.

Të ndërkombëtarizojë historinë e komunizmit në Shqipëri, përmes zgjerimit të rrjetit të aktiviteteve dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Të pasurojë *database*-in me të dhëna statistikore të viktimave të komunizmit në Shqipëri, në të tria kategoritë: ekzekutim, burgim dhe internim, si dhe t'i bëjë të aksesueshme për qytetarët.

Miratuar në datën 10.5.2018

KRYETARI
Gramoz Ruçi